

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Data 24.03.2023**

**Ora.15:00**

**RENDI I DITES**

**Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr.11, datë 25 mars 2021 të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, i ndryshuar”.**

**PJESËMARRJA:**

**• Komisioni Rregullator:**

**• Ilirjana NANO Kryetare**

**• Arens ÇELA Anëtar**

**• Dritan ÇAKA Anëtar**

**• Helga VUKAJ Anëtare**

**• Muharrem ÇAKAJ Anëtar**

**• Stafi i KQZ-së: Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta, E. Dushollari**


**Parti Politike:**

**OJQ: KRIIK**

*Znj. I. Nano:* Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Më së pari, verifikojmë praninë. Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator: sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, zyrtarë të tjerë të administratës dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi shqyrtimin e projektaktit “Për disa ndryshime në

1

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

vendimin nr. 11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes së organizmit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit” i ndryshuar. Kolegë, para se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektakti, kemi ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar, apo për të ndryshuar rendin e ditës? Nuk ka. Fillojmë me shqyrtimin e këtij akti. Akti ka ardhur për shqyrtim në Komisionin Rregullator me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kështu që do t’i lutesha sekretarit të Përgjithshëm të bënte një prezantim të ndryshimeve të propozuara dhe arsyet e këtyre ndryshimeve. Zoti Merkaj.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij parashikohet në nenin 20, pika 1, shkronja “d” të Kodit Zgjedhor. Referuar këtij parashikimi është përgatitur edhe projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr.11 të datës 25.03.2021”. Qëllimi i vendimit nr. 11, të 2021-shit është organizimi dhe funksionimi i komisionit të qendrës së votimit, si dhe përcaktimi i rregullave për ngritjen, organizimin, funksionimin e qendrës së votimit, marrjen e vendimeve dhe për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Projektvendimi i propozuar adreson një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e procesit të zgjedhjeve në qendrën e votimit. Në projektaktin e paraqitur propozohet shfuqizimi i shkronjës “d” të pikës 2, të nenit 10, e cila adreson rekomandimin nr. 7 të OSBE –ODIHR-it për zgjedhjet e datës 25 prill 2021, sipas të cilës, për të garantuar sigurinë juridike dhe adresimin efikas të zgjedhjeve, aktet e detyrueshme nënligjore duhet të jenë në përputhje me legjislacionin primar dhe duhet të miratohen në kohë. Heqja e parashikimit se subjekti zgjedhor, që i ka propozuar, kërkon zëvendësimin e tyre, e sjell normën në

2

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

përputhje me parashikimin e nenit 39 të Kodit Zgjedhor. Në nenin 26 të vendimit është propozuar ndryshimi i shkronjës “d” të pikës 2, e cila konsiston në përshtatjen sa më cilësore të normës nga pikëpamja e teknikës legislative. Pika 2 e nenit 27 është riformuluar duke përcaktuar procedurën e mbylljes dhe futjes së zarfit të procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si dhe procedurën për administrimin e raportit të hapjes së pajisjes së identifikimit elektronik. Duke qenë se në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore votohet me 2 kuti, respektivisht në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë dhe kutinë e votimit për këshillin e bashkisë, referuar nenit 101, pika 1 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se origjinali i procesverbalit të vulosjes së kutisë të votimit mbyllet në zarfin: “zarfi i procesverbalit të vulosjes”, i cili futet në kutinë e votimit për subjektet zgjedhore përpara fillimit të votimit. Referuar përvojës së deritanishme, si dhe referuar nenit 120, pika 2 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet procedura e numërimit, sipas të cilës për çdo bashki numërimi fillon me vota për kryetarin e më pas vijon me numërimin e votave për këshillin e bashkisë, është përcaktuar se zarfi i procesverbalit origjinal të vulosjes vendoset në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë, ndërsa kopjet e tjera vendosen në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe në kutinë e materialeve zgjedhore. Në çdo rast është përcaktuar se raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik futet në kutinë e materialeve të votimit, ndërkohë që në aktin ekzistues ky dokument parashikohet të vendoset në kutinë e votimit. Arsyeja e rishikimit të kësaj procedure ka të bëjë me faktin se raporti i hapjes së procesit të identifikimit është dokument ekuivalent me listën e zgjedhësve, e cila futet në kutinë e materialeve zgjedhore. Neni 30 i vendimit risillet i përshtatur nga pikëpamja e teknikës legislative, si dhe vendos kufizimin në lidhje me numrin e tentativave për depozitimin e gjurmëve të gishtërinjve deri në 3 herë, me qëllim racionalizimin e

3

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

procesit për shkak se tentativat për skanime të shpeshta mund të jenë të panumërta dhe të pandërprera. Neni 31 i vendimit risillet në një procedurë të rishikuar në lidhje me rastet e veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësve. Në procesin e rigjeneruar është saktësuar se nëse zgjedhësi, qoftë ai zgjedhës që është i regjistruar në listën e zgjedhësve, ashtu edhe ai që nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi, për të cilën është e pamundur të depozitohen gjurmët e gishtave, zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve dhe pasi pajisja PEI printon kuponin, zgjedhësi nënshkruan kuponin për të vendosur emër, mbiemër dhe nënshkrimin në fletën e pastaj pajiset me fletën e votimit. Në nenin 38, që normon administrimin e informacionit paraprak në ditën e zgjedhjeve, është parashikuar se ky proces nuk kryhet më nga sekretari i qendrës së votimit, në rast se transmetimi realizohet nga pajisja PEI drejt Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu, në nenin 41, pika 6 është propozuar riformulimi, duke përshtatur administrimin e procesverbalit të mbylljes së votimit për secilin proces zgjedhor. Në vendimin ekzistues përcaktohet procedura vetëm në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend dhe nuk kishte përcaktime për procedurën e vendosjes së procesverbalit të mbylljes në organet e qeverisjes vendore. Gjithashtu, është përcaktuar se raporti i gjeneruar nga PEI automatikisht me mbylljen e procesit do të trajtohet në përputhje me nenin 113, pika 5 të Kodit Zgjedhor, që futet në rutinë e materialeve të votimit. Gjithashtu, në respektim të parimit të ruajtjes të dhënave personale është parashikuar se një kopje e raportit mbyllës të identifikimit elektronik do t'u jepet anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit dhe vëzhguesve të partive politike të riprintuar pa përfshirë numrin rendor në listën e zgjedhësve. Bashkëngjitur keni projektvendimin për shqyrtim e miratim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

4



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Merkaj! Atëherë, fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë, keni diçka në parim? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

**Kush është dakord në parim, kolegë?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Me 5 vota pro miratohet.**

Atëherë kalojmë në votimin nen për nen. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi: “Në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, bëhen ndryshime si më poshtë vijon:

1. Shkronja “d” e pikës 2 të nenit 10 shfuqizohet.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 1(znj.Nano)

**Kundër:** 4(z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Nuk miratohet propozimi i paraqitur në pikën 1.**

Kalojmë në pikën 2.

Shkronja “d” e pikës 2 të nenit 26 ndryshohet si më poshtë:

“Operatori teknik i QV-së identifikohet si përdorues i PEI-t duke shtypur në ekranin e PEI-t kodin e operatorit.”


**Kush është dakord?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Me 5 vota pro miratohet.**

2. Pika 2 e nenit 27 ndryshohet si më poshtë:



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

“Sekretari i KQV-së mbyll origjinalin e procesverbalit të vulosjes të kutisë së votimit në zarfin ku është shkruar: “zarf i procesverbalit të vulosjes” dhe e fut atë në kutinë e votimit para fillimit të procesit të votimit. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore procesverbali i vulosjes së kutisë së votimit hartohet në 3 kopje, ku njëra është origjinale dhe 2 janë kopje të saj. Sekretari i KQV-së mbyll origjinalin e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit në zarfin ku është shkruar: “zarf i procesverbalit të vulosjes” dhe e fut atë në kutinë e votimit për kryetarin e bashkisë. Kopjet e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit mbyllen respektivisht në 2 zarfet, ku në secilin është shënuar: “zarf i procesverbalit të vulosjes” dhe një zarf futet në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe tjetri në kutinë e materialeve të votimit. Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik, sipas pikës 3, të nenit 26 të këtij vendimi, futet në kutinë e materialeve të votimit.” Për këtë pikë kemi diçka për të diskutuar, apo të kalojmë në votim?

***Kush është dakord me pikën 3, kolegë?***

***Pro:** 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

***Kundër:** S’ka.*

***Me 5 vota pro miratohet.***

Pika 4. Neni 30 ndryshohet si më poshtë vijon:


Neni 30, “Identifikimi elektronik i zgjedhësit”.

1. Operatori teknik i QV-së:

a) Skanon me rrëshqitje letërnjoftimin ose pasaportën e zgjedhësit në hapësirën e lexuesit MRZ të PEI –it. Nëse zgjedhësi është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së dhe nuk është identifikuar më parë, në ekran shfaqen: emri, mbiemri, numri personal, fotografia dhe numri rendor i zgjedhësit në listën e zgjedhësve. PEI-i, përmes ngjyrës jeshile në ekran, vërteton se të dhënat e identitetit të zgjedhësit u lexuan me sukses.

***Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA***

6

P. 

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

b) Orienton zgjedhësin të depozitojë në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI-it gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë. Të riprovojë depozitimin e gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë, kur në depozitimin e parë gjurma nuk u lexua nga PEI-i, deri në 3 herë. Kur pas kryerjes së veprimeve sipas nënplikave “i” dhe “ii”, PEI-i nuk konfirmon depozitimin e gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë të zgjedhësit, operatori teknik i kërkon zgjedhësit të depozitojë gjurmën e gishtërinjve të tjerë, sipas orientimeve që shfaqen në ekranin e PEI-it.

c) I dorëzon kryetarit të KQV-së dokumentin fizik të printuar nga PEI për kryerjen e identifikimit elektronik të zgjedhësit, i cili përmban: numrin e QV-së, datën dhe orën e kryerjes së verifikimit, emrin, mbiemrin, numrin personal dhe fotografinë e zgjedhësit, numrin e zgjedhësit në listën e zgjedhësve të QV-së.

ç) Kryetari i KQV-së administron dokumentin fizik të dorëzuar nga operatori në zarfin ku është shënuar: “vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”.

d) Zgjedhësit i jepet fleta e votimit pasi ai ka kryer identifikimin elektronik.

dh) Përpara se zgjedhësit t’i jepet fleta e votimit, ajo vulozet në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e kryetarit të KQV-së.

2. Në rastet kur për shkak të dëmtimeve fizike dokumenti i identitetit të zgjedhësit nuk lexohet nga PEI, operatori teknik i QV-së shtyp në mënyrë manuale të dhënat e zgjedhësit në ekranin e PEI.

3. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të kryejë verifikimin elektronik, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së.

Para se të kalojmë në votim, unë kam për administratën nja 2 rregullime të vogla gjatë zbardhjes dhe vetëm te germa “b” në nënndarjen “2/i”, thjesht do të mendoja një spostim të togfjalëshit: ‘të riprovojë depozitimin e gjurmës së gishtit të madh



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

deri në 3 herë, kur në depozitim e parë gjurma nuk u lexua nga PEI”. Nuk e di nëse ju shkon, nuk është çështje ndryshimi për të propozuar, por gjatë zbardhjes le ta shikojë administrata. Ndërkohë kam një pyetje. Te pika 3 thuhet: “në rast se zgjedhësi nuk pranon të kryejë verifikimin elektronik”, çfarë përfaqëson “verifikimi elektronik” në këtë rast, se kemi folur për nënshkrim elektronik, identifikim elektronik, për çfarë bëhet fjalë “verifikim elektronik”?

*(Diskutim pa mikrofon)*

**Znj. I. Nano:** Të nënshkruajë, është nënshkrim. Nëse është karta, është identifikim, nëse jeni në momentin e vendosjes së gjurmëve të gishtit është nënshkrimi, kështu që..

**Znj. H. Vukaj:** Saktësoji: Si përshkruhet njëra dhe si përkufizohet tjetra.

**Znj. I. Nano:** Mund ta ndizni mikrofonin. Për çfarë bëhet fjalë “nuk pranon të kryejë verifikimin elektronik”.

*(Diskutim pa mikrofon)*

Prandaj po e ndryshojmë për të bërë harmonizim, xhenerim, gjenerim, riformulim etj, etj. Në propozimin që na ka ardhur sot çfarë keni parasysh me verifikim elektronik? Identifikim. Atëherë gjatë zbardhjes duhet ta vendosim “identifikim”. Atëherë pas këtyre korigjimeve që do të bëhen pas zbardhjes, ftoj kolegët të votojnë pikën 4.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S’ka.

**Me 5 vota pro miratohet.**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*





*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

Neni 31 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 31 “Rastet e veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësit”.

1. KQV-ja lejon operatorin teknik të QV-së të vijojë me identifikimin e zgjedhësve që paraqiten në qendrën e votimit në rastet e mëposhtme:

- a. Zgjedhësi, i cili nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit dhe paraqitet për të votuar me vendim gjykate, i cili i jep të drejtën të votojnë në atë qendër votimi.
- b. Anëtarët e KQV-së, anëtari i KZAZ-së, i pajisur me vendim të KZAZ-së për të votuar në atë QV, të cilët nuk janë të regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së.
- c. Operatori teknik i QV-së, personi i ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës, nëse janë zgjedhës të zonës zgjedhore.

Unë kam një diskutim që më lindi tani duke lexuar, po ta mbaroj leximin një herë deri në fund të të gjitha pikave.


Pika 2.

Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni operatori teknik i QV-së:

- a) Shtyp në ekranin e PEI-it butonin “rast i veçantë”.
- b) Skanon dokumentin e identifikimit të zgjedhësit në hapësirën EMRZ.
- c) Pas leximit të të dhënave të zgjedhësit nga PEI-i, zgjedhësi depoziton gjurmën e gishtit në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI –it.

3. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së, por është i pajisur me vendim gjykate, i cili i jep të drejtën të votojnë atë qendër votimi, KQV-ja shënon emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit, numrin e dokumentit të identifikimit në një regjistër të posaçëm, të cilit i bashkëlidh vendimin e gjykatës. Pas regjistrimit të të dhënave të zgjedhësit të pajisur me vendim gjykate në regjistrin e posaçëm, KQV-ja lejon operatorin teknik të QV-së të kryejë identifikimin elektronik të zgjedhësit.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

4. Në rastet kur pavarësisht ndjekjes së procedurave të përcaktuara në nenin 30, pika 1 shkronja “b” të këtij vendimi, është e pamundur të depozitohen gjurmët e gishtërinjve, ndiqet kjo radhë veprimesh:

a) Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve duke shënuar emrin, mbiemrin dhe firmën.

b) Pajisja PEI printon dokumentin fizik, që evidenton zgjedhësin e identifikuar pa shenja gishtërinjsh.

c) Zgjedhësi nënshkruan në dokumentin fizik të printuar duke shënuar emrin, mbiemrin dhe firmën.

ç) Zgjedhësit i dorëzohet fleta e votimit.

d) Sekretari i QV-së e pasqyron këtë fakt në librin e protokollit të mbledhjeve duke shënuar orën, identitetin e zgjedhësit me shënimin: “Zgjedhësi u identifikua me nënshkrim pa shenjë gishtërinjsh”. Evidentimi i faktit në librin e protokollit të mbledhjeve nënshkruhet nga sekretari i QV-së dhe operatori.

5. Sekretari i KQV-së mban shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV – së rastet ku KQV-ja ka lejuar identifikimin elektronik të zgjedhësit, sipas pikës 1 të këtij neni. Është një nen i gjatë, në fakt.

Kolegë fillojmë diskutimet. Unë personalisht kam për pikën 4, një propozim për riformulim. Ju për 3 pikat e para? Atëherë te pika “c”, unë kam një pyetje. “Rastet e veçanta të identifikimit elektronik të zgjedhësit, mes të cilave përfshihen dhe rastet e votimit të operatorit teknik të QV-së, personi i ngarkuar me detyrë, nëse janë zgjedhës të zonës zgjedhore”. Duket e kushtëzuar. Në fakt, ne sapo kemi miratuar pak më herët një vendim për kriteret e përzgjedhjes së operatorëve dhe kriteri i përgjithshëm, kushti dhe rregulli kryesor janë që operatorët do të jenë zgjedhës të zonës përkatëse zgjedhore, që në këtë rast është bashkia. Përrjashtim

P. 

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

është rasti kur nuk janë zgjedhës të asaj zone zgjedhore, kurse këtu këtë që është rregull e kemi futur tek rastet përjashtimore. Nga administrata, kush e do fjalën?

**Znj. M. Koja:** Në fakt, pika 1 e nenit 31, trajton dy kategori që Kodi njih si zgjedhës të veçantë, por, në tërësinë e tij, neni 31 trajton rastet e veçanta të identifikimit. Në shkronjat “a” dhe “b”, në përputhje me Kodin Zgjedhor janë zgjedhësit e veçantë. Te zgjedhësit e veçantë janë vetëm anëtarët e KQZ-së, sikundër kodi i njih, dhe zgjedhësit, të cilët janë të pajisur me një vendim gjykatë për të votuar në atë qendër votimi. Krahas këtyre dy kategorive të zgjedhësve të veçantë është evidentuar edhe operatori teknik, që Kodi nuk e njih si zgjedhës të veçantë, por ai mund të votojë në qendrën e votimit nëse është në listën e zgjedhësve të asaj...

**Znj. I. Nano:** Të asaj qendre.

**Znj. M. Koja:** Të asaj zone zgjedhore. Ai mund të mos jetë në listën e asaj QV-je, por është i listët së asaj bashkie. Pavarësisht këtij fakti ne e kemi evidentuar e kemi shtuar si rast të veçantë, pavarësisht se nuk kategorizohet, si zgjedhës i veçantë, në kuptim të Kodit.

**Znj. I. Nano:** Cila është arsyeja?

**Znj. M. Koja:** Sepse ai do të votojë aty.

**Z. Y. Merkaj:** Për këtë zonë zgjedhore, pra i japim autorizim, atëherë do të marrin nga një zonë tjetër operatorët.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Znj. I. Nano:** Pra, ju po justifikoheni me interesin më të lartë për të votuar.

**Znj. M. Koja:** Patjetër do ta orientojmë më saktë, të themi, KQV-në që lejon operatorin të veprojë në këtë mënyrë për operatorë, të cilët, pavarësisht se nuk e kanë emrin në atë listë të asaj QV-je, janë të asaj zone zgjedhore. Kjo është një gjë e verifikueshme nga sistemi PEY.

**Znj. I. Nano:** Atëherë, do të ishin disa raste dhe prandaj unë këmbëngul në kërkesën për sqarim, sepse jam e ndërgjegjshme për aktin që kemi miratuar vetë më herët. Cilat do të ishin rastet potenciale? 1. Operatori, personi i ngarkuar me përdorimin e kamerës të ishte jo thjesht zgjedhës i zonës zgjedhore, por ta kishte emrin në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi; 2. Të ishte në atë zonë zgjedhore, por jo në atë qendër votimi dhe 3. Nuk është zgjedhës i asaj zone zgjedhore. Dhe për këtë kategorinë e tretë jemi të qartë, sepse kemi miratuar edhe situatën që kërkohet pëlqimi i vetë operatorit për të shkuar për të ofruar shërbimin në një zonë jashtë zonës së tij zgjedhore, ose me fjalë të tjera, nuk do të arrijë të votojë. Që do të thotë rregulli i përgjithshëm është: operatori voton, te akti tjetër e kemi ne “nëse nuk është i zonës zgjedhore, nuk voton”. Çfarë keni pasur parasysh me këtë “nëse është zgjedhës i zonës zgjedhore”?

**Znj. M. Koja:** Ju propozoni ta heqim?

**Znj. I. Nano:** Jo, kërkoj të sqarohem, sepse keni përfshirë këtu zonën zgjedhore, por ndërkohë është e lidhur me qendrën e votimit.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Z. M. Çakaj:** Me sa kuptoj unë qëllimi që ka pasur ndër mend administrata ta vendosë këtë është që, në rastet e veçanta të identifikimit, krahas zgjedhësve të veçantë, të parashikuar nga neni 58, që e fitojnë këtë cilësi në bazë të nenit 58 të Kodit Zgjedhor, janë edhe operatorët, të cilët nuk janë në atë qendër votimi, maksimalisht mund të ketë një mijë zgjedhës, por të cilët kanë nënshkruar një kontratë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të kryer detyrën e operatorit dhe në këtë rast këto do të konsiderohen si rate të veçanta edhe të zgjedhësit, por edhe të identifikimit që është hapi i parë. Pra, këtë kemi pasur ndër mend.

**Znj. I. Nano:** A ka raste kur operatori, që ofron shërbimin për KQZ-në caktohet me detyrë në qendrën e votimit ku është votues?

**Z.Y. Merkaj:** Po.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Ta votojmë pikë pas pike. Po, pra që është një rast tjetër. Mund të jenë tri raste ku mund të jetë operatori i caktuar: 1 në qendër e votimit ku është zgjedhës; 2. Në çdo qendër tjetër të zonës zgjedhore dhe 3. Përtej zonës së tij zgjedhore.

**Z. M. Çakaj:** Kur është zgjedhës nuk kemi pse, sepse është zgjedhës, i vetmi rast, te rasti tjetër ne e kemi hequr me aktin e mëparshëm, pra e kemi bërë të papajtueshëm funksionin vetëm në rast se ai jep pëlqimin, shkon diku tjetër. Pra, heq dorë në mënyrë vullnetare nga e drejta kushtetuese për të votuar.

**Znj. I. Nano:** Pra, përjashtimi këtu është nëse nuk është zgjedhës i asaj qendre. A më kuptoni, këtë jam duke kërkuar të sqarohem.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Znj. M. Koja:** A mund të shtoj dhe të propozoj? Pra, nëse nuk është zgjedhës në atë qendër votimi, por është zgjedhës i asaj zone zgjedhore.

**Znj. I. Nano:** Pra, ta bëjmë me saktësi këtë gjë dhe nuk ka nevojë për votim. Atëherë, doni që ta kalojmë pikë për pikë? Atëherë, votojmë pikën 1 të këtij neni më këtë saktësim nga ana e administratës.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Miratohet pika 1 me 5 vota pro.**

Pika 2, nuk kemi propozime për ndryshime.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Miratohet pika 2 me 5 vota pro.**

Pika 3.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Miratohet pika 3 me 5 vota pro.**

Për pikën 4 unë kam disa pyetje, dhe pasi të marr përgjigje për to, ose një pyetje më mirë të themi, do të propozoj një reformulim. Unë e lexova pikën 4, por të shkronja "a" keni parashikuar: Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve duke shënuar emër, mbiemër, firmë. Lista e zgjedhësve e përmban të printuar emrin dhe mbiemrin apo jo? Çfarë përmban në kolona? Emër, mbiemër, numër personal,

14

**Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA**



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

numrin në listën e zgjedhësve të asaj qendre? Dakord e kisha për ta saktësuar këtë që të bëj propozimin konkret. Atëherë unë propozoj një riformulim të pikës 4: Në rastet kur pavarësisht ndjekjes së procedurave të përcaktuara në nenin 30, pika 1, shkronja “b” të këtij vendimi është e pamundur të depozitohen gjurmët e gishtërinjve ndiqet kjo radhe veprimesh: a. zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve”. Këto të tjerat janë pjesë të pronturra të listët së zgjedhësve, emër mbiemër; b. Pajisja PEI printon dokumentin fizik që evidenton zgjedhësin e identifikuar pa shenja gishtërinjsh dokument në të cilin zgjedhësi shënon emrin, mbiemrin dhe firmën”. Në këtë mënyrë shkronjat “b” dhe “c” bëhen 1. Po e lexoj edhe njëherë kolegë. “Pajisja PEI, printon dokumentin fizik që evidenton zgjedhësin e identifikuar pa shenja gishtërinjsh, dokument në të cilin zgjedhësi shënon: emrin, mbiemrin dhe firmën. Shkronja “ç” bëhet shkronja “c”, sipas propozimit. “Zgjedhësit i dorëzohet fleta e votimit”. Pas shkronjës “c” të propozuar propozoj të shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje: Zgjedhësit nuk i dorëzohet fleta e votimit vetëm në rast se nuk ka nënshkruar në listën e zgjedhësve sipas shkronjës “a” të këtij neni. Vazhdojmë me shkronjën “d”: “Sekretari i QV-së i pasqyron këto fakte në librin e protokollit të mbledhjeve duke shënuar orën, identitetin e zgjedhësit, me shënimin: “zgjedhësi u identifikua me nënshkrim pa shenjë gishtërinjsh, si dhe rastet e mosnënshkrimit të dokumentit të printuar nga PEI. Evidentimi i fakteve në librin e protokollit të mbledhjeve nënshkruhet nga sekretari i QV-së dhe operatori”. Kolegë ky ishte propozimi im për riformulimin. Pra, në shkronjën “a” heqim emër, mbiemër, firmë, shkronja “b” dhe “c” bashkohen në një me atë formulim që thamë, shkronja “ç” shndërrohet në “c” me të njëjtën përmbajtje, shtohet një shkronjë “ç” dhe riformulohet shkronja “d”. A është e qartë?



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Z. M. Çakaj:** Po është e qartë, po unë kam një pyetje për administratën. Të gjitha këto parashikime dhe hapa proceduare, që ne po propozojmë dhe po miratojmë, a do të materializohen në konfigurimin teknik të pajisjes elektronike?

**Z. E. Dushallai:** Patjetër.

**Z. M. Çakaj:** Të gjitha që ne do të miratojmë do të konfigurohen hap pas hapi në pajisjen elektronike. Sigurisht bëhet fjalë për një rast të veçantë të identifikimit të zgjedhësit.

**Z. E. Dushallai:** Këto do të reflektohen në sistemin operativ të pajisjes.

**Z. M. Çakaj:** Pra, është e mundur teknikisht?

**Z. E. Dushallai:** Po.

**Z. I. Nano:** Dakord. Kolegë, a keni ndonjë gjë tjetër apo të kalojmë të votimi i pikës 4?


**Kush është dakord me propozimin e bërë, kolegë?**

**Pro:** 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Miratohet pika 4 me 5 vota pro.**

E kam lexuar dhe pikën 5, po e rilexoj: “Sekretari i KQV-së mban shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së rastet kur KQV-ja ka lejuar identifikimin elektronik të zgjedhësit, sipas pikës 1 të këtij neni”.





*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

***Kush është dakord me propozimin e bërë, kolegë?***

***Pro: 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Miratohet pika 5 me 5 vota pro.***

Vijojmë, pika 6: “Në nenin 38 pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje: Në rast se transmetimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni realizohet drejtpërdrejtë nga PEI në KQZ, lloji i të dhënave të transmetuara dhe mënyra e transmetimit do të bëhet në përputhje me vendimin nr. 7, datë 20 .02.2023 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e llojit të të dhënave që transmetohen nga pajisja elektronike e identifikimit drejt strukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit TIK, të KQZ-së dhe rregullat për mënyrën e transmetimit të tyre”. A keni ndonjë pyetje për këtë pikë? Jo.

***Kush është dakord me propozimin e bërë, kolegë?***

***Pro: 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)***


***Kundër: S'ka.***

***Miratohet pika 6 me 5 vota pro.***

Pika 7: “Pika 6 e nenit 41 ndryshohet si më poshtë: “Numrat e kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit shënohen paraprakisht në procesverbalin për mbylljen e votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së. Pasi hidhen të gjitha të dhënat në procesverbalin për mbylljen e votimit shënohet ora e saktë e mbylljes së procesverbalit. Origjinali i procesverbalit për mbylljen e votimit futet në kutinë e votimit, e cila vuloset menjëherë me Kodin e 5-të të sigurisë, ndërsa kopjet e tij futen në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vuloset me kodet përkatëse të sigurisë. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore origjinali i procesverbalit për mbylljen e votimit futet në kutinë e votimit për kryetar bashkie, kopje të

17

***Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA***



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

procesverbalit të mbylljes së votimit futen përkatësisht në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë dhe në kutinë e materialeve të votimit. Raporti i mbylljes i printuar automatikisht nga PEY sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij vendimi futet në kutinë e materialeve të votimit. Kopje të procesverbaleve për mbylljen e votimit dhe të raportit të mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve të riprintuar, pa përfshirë numrin rendor në listë të zgjedhësve, u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare”. Po, zonja Vukaj.

**Z. Vukaj:** Për të saktësuar diçka në paragrafin e dytë të pikës 7, të propozuar nga ju, do të kërkoja një specifikim ose qartësim të llojeve të procesverbaleve që i renditni këtu. Për të kuptuar nëse ka nevojë që t’i nominojmë dhe të shprehim saktësisht se çfarë lloj procesverbali duhet futur në secilën kuti, apo duhet t’i lëmë ashtu në gjendje të përgjithshme.

**Z. Y. Merkaj:** Kemi dy: i hapjes që quhet procesverbal i vulosjes dhe procesverbal i mbylljes.

**Z. H. Vukaj:** Dakord. Keni parasysh që kemi zgjedhje vendore, pra kemi dy kuti votohet për këshillat dhe votohet kryetarin.

**Z. Y. Merkaj:** Procesverbal i mbylljes ka dy ka vetëm Kodin e 5-të të kutisë së kryetarit dhe Kodin e 5-të të kutisë së këshillit bashkiak.

**Znj. I. Nano:** Unë kam një pyetje, mos ndoshta është fjalia e dytë e paragrafit të parë: “Pasi hidhen të gjitha të dhënat në procesverbalin për mbylljen e votimit shënohet ora e saktë e mbylljes së procesverbalit”?



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ora e mbylljes së procesverbalit apo e mbylljes së votimit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, ndaj them se mendoj se është lapsus ose shikojeni edhe një herë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht, pra se orë mbyllje procesverbali, pra te procesverbali i mbylljes, është ora e mbylljes së votimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht prandaj them ora e mbylljes së votimit, jo ora e mbylljes së procesverbalit gjatë zbardhjes.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*


Pra, një është origjinali, dy janë kopjet dhe vendosen përkatësisht në tri kuti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Njëra, origjinali në kutinë e votimit për kryetar, dy kopje përkatësisht njëra në kutinë e votimit për këshilli dhe tjetra në kutinë e materialeve të votimit. Atëherë, a keni diçka tjetër për këtë pikë? Në fakt, vende-vende i keni me shkronja të mëdha, vende-vende me shkronja të vogla, siç do të jenë të emërtuara në zarf, procesverbali i mbylljes së votimit më të mëdha të jenë, dukeni si gjëra të ndryshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Znj. M. Koja:** Si pjesë lineare e fjalie kur ti e specifikon dhe thua: procesverbali i mbylljes të dyja me shkronja kapitale dhe i vendos thonjëzat i jep një lloj etiketimi dhe vlere ndryshe. Kjo është ajo që nuk shkonte.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

**Znj. I. Nano:** Gjatë zbardhjes do të lutesha këtë dhe disa gjëra të tjera, diku është KQV, diku KQV-JA, dhe duke në rasi të ndryshme, KQV-SË, KQV-NË, edhe KQZ-JA, të gjitha duhet të jenë të harmonizuara dhe me aktin në fuqi. Atëherë, kalojmë në votimin e pikës 7.

**Kush është dakord, me propozimin e bërë, kolegë?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka.

**Miratohet pika 7 me 5 vota pro.**


Edhe për këtë kam diçka gjatë zbardhjes, sepse po kaloj tani te pika II, me numra romak, për mënyrën e të shkruarit të aktit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në çdo rast që ne kemi shtesa dhe ndryshime në akt fillojmë 1, 2 jo me numra romak.

**Znj. M. Koja:** Duke qenë se ky amendim, nga pikëpamja e teknikës, është i ngarkuar dhe ka shumë nënndarje në çdo ndryshim, konkretisht pika 3, pika 4 apo dhe pika 5 e vendimit, 5 numër natyror, po të shkojmë të neni ka shumë nënndarje dhe të vijonim me teknikën që të emërtojmë në vendimin nr. 11, pika I, romake, vijojmë më shkronjat a, b, c, ç, d, dh, amendimet, nga pikëpamja e teknikës na u duk i rënduar dhe menduam të zgjedhim këtë formë për të qartësuar, por mund ta kthejmë edhe ashtu.

**Znj. I. Nano:** Është e kuptueshme, por, nëse do t'i referohemi nesër këtij vendimi, si do të themi: I romak, II romak? Këtë kam merak, vetëm këtë. Gjithsesi gjatë zbardhjes e vlerësoni edhe njëherë.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Datë 24.03.2023*

*Znj. M. Koja: Po.*

*Znj. I. Nano: II. “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”*

*Kush është dakord, kolegë?*

*Pro: 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)*

*Kundër: S’ka.*

*Miratohet kjo pikë me 5 vota pro.*

III “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.”

*Kush është dakord, kolegë?*

*Pro: 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)*

*Kundër: S’ka.*

*Miratohet kjo pikë me 5 vota pro.*

Do të na duhet ta miratojmë edhe në tërësi pasi e kemi miratuar në parim dhe nen për nen dhe pasi kanë ndodhur jo pak ndryshime. Edhe një herë kolegë ju ftoj të votoni për miratimin në tërësi të vendimit Për disa ndryshime në vendimin nr. 11 datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator për mënyrën e ngritjes organizmit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe Zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit i ndryshuar.

*Kush është dakord me këtë pikë, kolegë?*

*Pro: 5(znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)*

*Kundër: S’ka.*

*Miratohet në tërësi me 5 vota pro.*

Meqë nuk kemi pikë tjetër të rendit të ditës për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur! Faleminderit!

**Vendimi nr.12**

21

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

